



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. 561

Tiranë 1/7/2025

VENDIM

Nr. 22, datë 1.7.2025

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI FUNKSIONIMIN E SISTEMIT INFORMATIK
PËR RAPORTIM DHE KOMPENSIM NË
AGJENCINË E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 26, pika 4 dhe pika 5, dhe të nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të kreut V të Udhëzimit “Për sigurimin e depozitave në banka”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. 3241, datë 18.12.2014, i ndryshuar, të kreut V të Udhëzimit “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim - kreditit”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. 4188, datë 1.9.2016, i ndryshuar, të nenit 6, nenit 15, të nenit 17 dhe të nenit 20 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar” të miratuar me Urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. 3762, datë 18.7.2016, i ndryshuar, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullores “Mbi funksionimin e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe njësitë e tjera të përcaktuara në këtë rregullore, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Rregullorja “Mbi funksionimin e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, e miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 28, datë 31.10.2016, shfuqizohet.





4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

